



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Doretuar Pritjeno/Prodato Received/Delivery	22.12.2022	2	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHCK	8377/2022		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.1089/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1089/2022 të datës 02.12.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në punësimet/Komuna e Skenderajt, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.12.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1089/2022 e datës 02.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi, përmes emailit [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net), më datë 02.12.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me nr. A.nr.1089/2022 me numër protokollit 7594/2022, kundër njoftimit për rezultatet e vlerësimit/testit me shkrim, jetëshkrimi dhe intervista lidhur me pozitën Specialit i Administrimit të Përgjithshëm -Zyrtar për Emergjencë 1.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullore Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.12.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunën e Skenderajt. Ndërsa, Këshilli më datë 15.12.2022 ka pranuar përgjigjen nga organi i punësimit me numër protokollit 8137/2022 bashkë me shkresat e lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 7594/2022 të datës 02.12.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Rezultatet përfundimtare të verifikimit paraprak të datës 15.08.2022; Njoftimi për rezultatin e vlerësimit për shpalljen e konkursit me nr.RN00009184; Njoftimi i datës 29.09.2022 për vlerësimin e rezultateve përfundimtare; E-mail i datës 28.10.2022; E-mail i datës 23.11.2022; Ankesa e datës 04.10.2022 e parashtruar për Komisionin e Vlerësimit; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 15.12.2022 nga organi i punësimit me numër protokolli 8137/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Kopja e konkursit e datës 08.06.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve për pozitën Specialist i Administrimit të Përhershëm-Zyrtar për Emergjencia 1; Lista e aplikantëve; lista e kandidatëve të aprovuar; lista e kandidatëve të refuzuar; Vendimi i datës 20.07.2022 i protokolluar me datën 26.07.2022 me nr.02-020/01-00763528/22 për emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e kandidatëve për pozitën Zyrtar për Emergjencia 1; Njoftimi i datës 29.09.2022 me nr.02-020/02-0045544/22 ; E-mail zyrtar i datës 28.10.2022 nga ankuesi; e-mail zyrtar i datës 28.10.2022 nga Menaxherja e Personelit; Diplomë e datës 21.06.2004 e shkollës së mesme; Diplomë e datës 22.06.2009 e lëshuar nga fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës dhe kontratë për Shërbime të veqanta prej datës 27.10.2014 deri më 27.11.2014; Vërtetim për përvojën e punës dhe Çertifikatë e datës 28.08.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, është e palejuar, *sepse*:

Nga administrimi i provave, Kolegji ka gjetur se Komuna e Skenderajt më datë 08.06.2022 ka publikuar konkursin me Nr.Reference RN00009184 për pozitën Specialist të Administrimit të Përgjithshëm- për pozitën Zyrtar për Emergjencia 1, ku afati për aplikim ka qenë nga data 29.06.2022 deri më datë 13.07.2022. Në këtë konkurs në bazë të listës së kandidatëve ka aplikuar dhe ankuesi, i cili është përfshirë në listën e ngushtë duke i'u nënshtruar procedurave të tjera të pranimit (testit me shkrim) i cili është mbajtur me datën 30.08.2022. Pas përfundimit të testit me shkrim të procedurës së pranimit për pozitën e lartcekur, Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Skenderaj po me të njëjtën datë ka njoftuar ankuesin se është vlerësuar me gjithsej 52 pikë duke mos kaluar në fazën tjetër të vlerësimit të kandidatëve e cila bazuar në dispozitat e nenit 21 paragrafi 4 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktohet se: *4.Vlerësimi maksimal i mundshëm për testimin me shkrim është deri ne shtatëdhjetë (70) pikë.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore i cili kërkon që komisioni vlerësues të rivlerësoj rezymenë ku ankuesi ka marrë 7.8 pikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë të shqyrtimit të provave të lëndës, konstaton se ankuesi pas njoftimit të datës 28.09.2022 i cili është njoftuar se nuk e ka kaluar testin me shkrim, me datën 04.10.2022 ankuesi ka parashtruar ankesë për Komisionin e Vlerësimit i cili me datë 28.10.2022 përmes e-mailit kërkon sqarime nga Menaxherja e Personelit lidhur me ankesën e datës 04.10.2022. Menaxherja e Personelit po ashtu përmes e-mailit të datës 28.10.2022 ka njoftuar ankuesin





se pas njoftimit përfundimtar të procedurës së rekrutimit për pozitën Zyrtar për Emergjencë 1 se keni parashtruar ankesë jashtë afatit ligjor, në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 5 i Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se : 5. *Kundër rezultatit të fazës së vlerësimit, kandidati i pakënaqur, mund të parashtrojë ankesë të brendshme, brenda tri (3) ditëve nga data e njoftimit individual.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, respektivisht njoftimin e datës 28.10.2022 nga Menaxherja e Personelit në Komunën Skenderajt, ka konstatuar se ushtrimi i ankesës me datë 02.12.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: “Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.1089/2022; datë 22.12.2022

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Skenderajt;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prizrenit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

